

VENDIM
Nr. 138, datë 21.8.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “TIRANA ENERGI” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pika 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.8.2020, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Tirana Energi” sh.p.k., si dhe relacionin nr. 96/2 prot., datë 13.8.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Tirana Energi” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Tirana Energi” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 997 prot., datë 22.7.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “Tirana Energi” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat: “a”, “b”, “c”) është plotësuar pjesërisht.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d” “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8; gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria “Tirana Energi” sh.p.k., është regjistruar pranë QKB-së në datën 7.8.2017, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” me statusin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.).

- Në objekt të veprimtarisë së saj shoqëria “Tirana Energi” sh.p.k. ka: financimin, ndërtimin e hidrocentraleve, prodhimin, furnizimin, transmetimin, shpërndarjen dhe shitjen e energjisë elektrike, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e hidrocentraleve, bazuar në ligjet e shtetit shqiptar.

Në lidhje me mungesën apo plotësimin e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:

- germa “c” (vërtetimi për regjistrim dhe ekstrakt historik nga Qendra kombëtare e biznesit, (QKB)). Plotësuar pjesërisht. Shoqëria ka përcjellë në ERE ekstraktin historik të QKB-së, datë 14.1.2020, nga përmbajtja e të cilit rezulton se shoqëria është regjistruar në datën 7.8.2017. Do t’i kërkohet shoqërisë të përcjellë certifikatën e regjistrimit pranë QKB-së dhe ekstraktin të përditësuar në data.

- germa “d” (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë). Plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të paraqesë vërtetimet e Gjykatës dhe Prokurorisë për vetë shoqërinë “Tirana Energi” sh.p.k. dhe përfaqësuesin ligjor të saj (neni 7, pika 4, germa “b”).

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal.
- Neni 9, pika 3, germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit). Pa plotësuar. Shoqëria duhet të paraqesë në ERE dokumentacionin përkatës.
- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8,
- germa “a”. Sasia e energjisë elektrike e parashikuar për tu tregtuar në GWh sipas viteve.
- germa “b”. Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj.

Do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti